



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 128

Tiranë – E mërkurë, 13 korrik 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 494, datë 1.7.2016	Për disa shtesa në vendimin nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar.....	10375
Urdhër i përbashkët i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Financave nr. 3069, datë 14.6.2016	Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në portet detare Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin.....	10376
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 37, datë 30.6.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 66, datë 27.2.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2014-3102, datë 9.10.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	10380
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 6.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-(384), datë 23.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	10383
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 6.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-1586 (221), datë 29.4.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	10387
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 6.7.2016	Me objekt shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 118, datë 19.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 148, datë 26.9.2000, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 26, datë 17.1.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	10391

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 6.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 2177, datë 20.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 514, datë 2.12.2011, të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 2647, datë 7.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 11155, datë 19.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.	10397
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 63, datë 6.7.2016	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Fondi për gratë sipërmarrëse në Bashkinë e Tiranës”.....	10406
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 3740, datë 4.7.2016	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Pedonalja Abaz Bej Lushnja”.....	10409
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Pëllumb Malko.....	10409
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Pellump (Pëllumb) Beqiraj.....	10409
	Kërkesë për shpalljen e vdekjes të shtetasit Elvis Ahmetli.....	10410

**VENDIM****Nr. 494, datë 1.7.2016**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 407, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E NJË REGJIMI KONTROLLI PËR TË
GARANTUAR RESPEKTIMIN E
RREGULLAVE TË POLITIKAVE
MENAXHUESE NË PESHKIM”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 72, pika 8, 74, pika 4, 77, pika 3, 82, pika 2, 101, pika 2, 112, pika 3, 113, pika 1, 116, 118, pika 3, e 135, pika 1, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 30, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 30.1, 30.2, 30.3, 30.4, 30.5, 30.6, 30.7, me këtë përmbajtje:

“30.1 QNOD-ja nëpërmjet SVA-së regjistron datën dhe orën e hyrjes e të daljes së anijeve të peshkimit nga dhe në zonat e mëposhtme:

a) të gjitha zonat sipas nenit 11, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”;

b) të gjitha zonat sipas nenit 104, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”;

c) të gjitha zonat që rregullohen nga organizatat rajonale të peshkimit, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;

ç) në ujërat nën sovranitetin e një shteti tjetër.

30.2 Në rast se pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, e instaluar në bordin e anijes, pëson defekt ose nuk funksionon gjatë lundrimit, kapiteni ose përfaqësuesi i anijes, duke filluar nga momenti kur është verifikuar defekti ose nga momenti i informimit sipas pikës 35, njofton çdo dy orë në QNOD për koordinatat gjeografike të azhurnuara të anijes me SMS ose nëpërmjet faksit apo komunikimit me radio.

30.3 QNOD-ja hedh në sistem menjëherë koordinatat gjeografike sipas pikës 32 në bankën e të dhënave të SVA-së. Të dhënat e hedhura në mënyrë manuale në bazën e të dhënave duhet të jenë lehtësisht të dallueshme nga mesazhet automatike të sistemit.

30.4 Në rastin kur pajisja për lokalizimin nga sateliti ka defekt teknik ose nuk funksionon, anija e peshkimit nuk mund të largohet nga porti deri në momentin kur ministria ose enti i caktuar prej saj të certifikojë që kjo pajisje e instaluar në bordin e anijes funksionon perfekt. Si përjashtim nga ky rregull, QNOD-ja mund të autorizojë anijet e peshkimit të lënë portin e peshkimit me një pajisje për lokalizimin nga sateliti jofunksionale, me qëllim riparimin ose zëvendësimin e saj.

30.5 Në rast se pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, e instaluar në bordin e anijes, rezulton jo plotësisht funksionale, QNOD-ja njofton menjëherë kapitenin e anijes ose përfaqësuesin e saj. Heqja e pajisjes për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit me qëllim riparimin e saj bëhet vetëm me miratimin e ministrisë.

30.6 Nëse për gjashtë orë rresht QNOD-ja nuk merr të dhënat sipas pikës 24, ajo informon menjëherë kapitenin ose përdoruesin e anijes së peshkimit apo përfaqësuesin e saj. Nëse për të njëjtën anije peshkimi ky fakt përsëritet me shumë se tri herë brenda vitit, ministria ose enti i caktuar prej saj kontrollojnë me imtësi pajisjen për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, duke verifikuar gjithashtu nëse është ndërhyrë në këtë pajisje. Për këtë qëllim, si përjashtim nga përcaktimi i pikës 28, pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit mund të çmontohet për t’u ekzaminuar.

30.7 Nëse për gjashtë orë rresht QNOD-ja nuk merr të dhënat sipas pikës 24 dhe anija e peshkimit në komunikimin e fundit ka qenë në ujërat e një shteti tjetër, QNOD-ja njofton shtetin tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur në lidhje me këtë çështje.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**URDHËR I PËRBASHKËT****Nr. 3069, datë 14.6.2016****PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PORTUALE NË PORTET
DETARE VLORË, SARANDË DHE SHËNGJIN**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 84, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992, “Për çmimet dhe tarifaf”, i ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministri i Financave

URDHËROJNË:

Kufiri maksimal i tarifave që do të përdoren nga Porti Detar i Vlorës, Sarandës dhe Shën-gjinit, janë si më poshtë:

KAPITULLI 1**TARIFAT E PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES****1. TARIFAT E PORTIT DHE TË KANALIT****1.1 Përkufizime****1. Interpretim**

- a) “Tarifa e kanalit” do të thotë një tarifë për një anije e cila përdor kanalën e lundrimit dhe basenin e portit, në portin e Shëngjinit;
- b) “Pronar” do të thotë agjenti, marrësi me qira (Charter) ose zotëruesi i anijes;
- c) “Port” do të thotë porti detar i organizuar sipas kuadrit ligjor në fuqi;
- ç) “Traget” do të thotë anije vetëm për pasagjerë dhe automjete;
- d) “RO-RO” do të thotë anije vetëm për automjete mallrash dhe/ose udhëtarësh;
- dh) “Certifikata e madhësisë së tonazhit” do të thotë një certifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes i njohur nga autoriteti detar, i cili vendos tonazhin e regjistruar neto (GT) dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

2. Aplikime

- a) Tarifa e kanalit aplikohet për ato anije të cilat vijnë në ose përdorin vetëm Portin e Shëngjinit.
- b) Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

3. Tarifaf

Tarifaf e portit dhe të kanalit duhet të llogariten sipas njërive që janë vendosur në tabelën e mëposhtme:

- a) Detyrimet për Portin dhe kanalën, të përcaktuara nga këto tarifa, janë të pagueshme menjëherë nga pronari ose agjenti i anijes në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës dhe mblidhen nga porti detar.
- b) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së portit dhe të kanalit, janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

4. Përmasat e anijes

- a) Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara në certifikatën e madhësisë së tonazhit, atëherë tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.
- b) Në qoftë se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë së tonazhit, porti detar ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto (GT) ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e tjera të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdoren si tonazh bruto apo përmasa të regjistruara, për efekt të kësaj tarife.

5. Përjashtime

1. Tarifaf e portit dhe kanalit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

- a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare ose një anije e një force vizitore;
- b) një anije që i përket qeverisë shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;



c) një anije që hyn në portin detar për qëllim vendstrehimi në rast të një stuhie apo aksidenti;
 d) një anije e përjashtuar nga aplikimi i tarifave, si rezultat i ndonjë marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

2. Përjashtime në rastet “Double banking”

a) Për rastet e ngarkim-shkarkimit të anijeve me tonazh të madh, ku procesi nuk mund të kryhet i plotë në kalatat e portit dhe do të realizohet nëpërmjet operacioneve “Double banking” në radën e portit detar;

i) Tarifa e portit dhe e kanalit do të aplikohet vetëm një herë për secilën anije për të gjithë procesin.

1.1.1 Tarifat maksimale (tavan) për kanalën të aplikueshme në portin detar Shëngjin.

1. Tarifat e kanalit për anije për prekje Njësia bazë Tarifa (€)

a) Për tragete €/GT 0.05;

b) Për anije të tjera përfshirë dhe anije RO/RO €/GT 0.07.

1.2 Tarifat maksimale të akostimit të aplikueshme në portet detare:

1.2.1 Përkufizime

1. Interpretim

a) “Tarifë vendakostimi/kalate” në këtë udhëzim do të thotë tarifa maksimale për një anije dhe/ose traget, e cila futet brenda dhe përdor ndonjë kalatë (vendakostim) në portet detare;

Portet detare mund të vendosin masën konkrete të tarifës jo më të madhe se tarifa e përcaktuar në këtë udhëzim;

b) “Pronar” do të thotë agjenti, marrësi me qira ose zotëruesi i anijes;

c) “Port detar” do të thotë Porti i Vlorës, Sarandës dhe Shëngjinit i organizuar sipas kuadrit ligjor në fuqi;

d) “Certifikata e madhësisë së tonazhit” do të thotë një certifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes i njohur nga administrata detare, i cili vendos tonazhin e regjistruar bruto (GT) ose/dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

2. Aplikime

a) këto tarifa aplikohen për ato anije të cilat vijnë në/ose përdorin portet detare;

b) këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

3. Tarifat e kalatës/vendakostimit

a) tarifat e kalatës/vendakostimit do të llogariten bazuar në tabelën e mëposhtme;

b) tarifat e kalatës/vendakostimit, të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë nga pronari apo agjenti i anijes, në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës dhe mbliidhen nga porti detar ose përfaqësuesit e tij;

c) detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së kalatës/vendakostimit janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

4. Përmasat e anijes:

a) nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara, në certifikatën e madhësisë së tonazhit, tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife;

b) në qoftë se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë së tonazhit, porti detar ose përfaqësuesi i tij, mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto (*Gross*) ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e tjera të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdoren si tonazh bruto apo përmasat e regjistruara, për efekt të kësaj tarife.

5. Përjashtime

Tarifat e kalatës/vendakostimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

a) një luftanije ose ndonjë anije nën koman-dën e forcave shqiptare ose një anije e një force vizitore;

b) një anije që i përket qeverisë shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

c) një anije e përjashtuar nga aplikimi i këtyre tarifave, si rezultat i ndonjë marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

1.2.2 Tarifat e kalatës/vendakostimit



1. Tarifat maksimale të kalatës/ vendakostimit për anijet janë të llogaritura bazuar në përmasat e anijes (tonazhi i regjistruar bruto GT sipas akostimit) si dhe kohës së qëndrimit:	Njësia bazë	Tarifa (€)
a) anije që ngarkojnë ose shkarkojnë materiale të përgjithshme	€/GT	0.07;
b) anije që ngarkojnë ose shkarkojnë mallra likuide ose rifuxho	€/GT	0.10;
c) anije RO/RO udhëtarësh, sportive, jahte etj., mbi 100GT	€/GT	0.07;
d) për jahte, motoskafe, veliera (mjete të vogla turistike dhe hidroplanë nën 100GT	€/ditë	10.

Shënim. Për anijet me flamur shqiptar, tarifet zbatohen në masën 50%.

Për qëndrimin në kalatë pas përfundimit të veprimeve tregtare 3 euro për metër linear (LOA), për çdo ditë apo pjesë të saj.

2. Tarifat për anijet me flamur shqiptar të cilat kanë mbaruar proceset e ngarkim-shkarkimit të mallrave	Njësia bazë	Tarifa (€)
Këto tarifa janë të llogaritura bazuar në kategorinë e madhësisë të anijes GT (tonazh bruto), gjatësinë e anijes dhe kohën e qëndrimit		
a) për anijet deri në përfshirë 500 (GT)	€/për muaj	40;
b) për anijet 501 deri në dhe përfshirë 1,000 (GT)	€/për muaj	70;
c) për anije mbi 1,001 deri në 3,000 GT	€/për muaj	100;
d) për anije nga 3,001 deri në 5,000 GT	€/për muaj	150;
e) për anije nga 5,001 deri në 10,000 GT	€/për muaj	200;
f) për anije mbi 10,000 NRT	€/për muaj	300.

KAPITULLI 2

TARIFAT MAKSIMALE PËR SHËRBIMIN E PILOTIMIT DHE ORMEXHIMIT

2.1 TARIFAT MAKSIMALE PËR SHËRBIMIN E PILOTIMIT

a) për anijet deri në dhe përfshirë 500 (GT)	€	20;
b) për anijet 501 deri në dhe përfshirë 1,000 (GT)	€	30;
c) për anije mbi 1,001 deri në 2,000 GT	€	40;
d) për anije nga 2,001 deri në 3,000 GT	€	70;
e) për anije nga 3,001 deri në 5,000 GT	€	110;
ë) për anije nga 5,001 deri në 10,000 GT	€	190;
f) për anije nga 10,001 deri në 15,000 GT	€	250;
g) për anije nga 15,001 deri në 20,000 GT	€	300;
gj) për anije nga 20,001 deri në 25,000 GT	€	400;
h) për anije mbi 25,000 GT për çdo 10.000GT	€	80 € shtesë mbi tarifën 400.

2.1.1 Për anijet turistike, sportive, jahte etj., me kapacitet deri në 100 GT shërbimi i pilotimit paguhet mbi bazë të GT-së së anijes me tarifën 0.01 €/GT, por jo më pak se 5 €.

2.1.2 Për shërbimin e pilotimit që kryhet për anijet e ngarkuara me mallrat e rrezikshme dhe karburante, shtesa nuk duhet të kalojë 20% të tarifës së mësipërme.

2.1.3 Kur shërbimi i pilotimit kryhet pa ndihmën e makinerisë së anijes nga rada në kalatë dhe anasjelltas, tarifet e mësipërme aplikohen me 100% rritje.

2.2 Tarifat për ormexhimin

a) për anijet deri në dhe përfshirë 500 (GT)	€	10;
b) për anijet 501 deri në dhe përfshirë 1,000 (GT)	€	20;
c) për anije mbi 1,001 deri në 3,000 GT	€	30;
d) për anije nga 3,001 deri në 6,000 GT	€	50;
e) për anije nga 6,001 deri në 10,000 GT	€	100;
ë) për anije mbi 10,000 GT	€	140;



2.2.1 Kur anija lëviz nga një kalatë në tjetrën paguhet 100% e tarifës;

2.2.2 Kur anija lëviz me cima në të njëjtën kalatë më shumë se 50 ml pagesa do të bëhet me 50% zbritje;

2.3 Përkufizime të tjera për imbarkimin/disimbarkimin e pasagjerëve

1. Këto tarifa janë tarifatat tavan që paguhen nga zotëruesi i anijes/tragetit ose agjenti i tij, për imbarkimin dhe disimbarkimin e pasagjerëve në/nga anija/trageti dhe mblidhen nga porti detar. Portet detare mund të vendosin masën konkrete të tarifës jo më të madhe se tarifa e përcaktuar në këtë udhëzim.

2.4 Tarifatat maksimale e imbarkimit dhe disimbarkimit të pasagjerëve

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Detyrimi (€)
1. Imbarkim dhe disimbarkim (gjithsej) i pasagjerëve në tragete			
a)	pasagjerë 0–2 vjeç	person	0;
b)	pasagjerë me moshë 2–12 vjeç	person	2;
c)	pasagjerë mbi 12 vjeç	person	5.
2. Imbarkimi dhe disimbarkimi (gjithsej) i pasagjerëve në kroçerë			
a)	pasagjerë 0–2 vjeç	person	0;
b)	pasagjerë me moshë 2–12 vjeç	person	1;
c)	pasagjerë mbi 12 vjeç	person	3;
3. Imbarkimi dhe disimbarkimi (gjithsej) i pasagjerëve në hidroplanë			
		person	1.

2.5 Tarifatat maksimale të aplikueshme për forcën e sigurisë së portit (FSP)

1. Tarifa maksimale për forcën e sigurisë	Njësia bazë	Detyrimi (€)
a) pasagjerët në imbarkim me linja ndërkombëtare	Person	0.5;
b) pasagjerët në zbarkim me linja ndërkombëtare	Person	0.5;
c) imbarkim për mjetet deri në 3,5 tonë	Automjet	1;
d) zbarkim të mjeteve deri dhe 3,5 tonë	Automjet	1;
e) imbarkim për mjetet mbi 3,5 tonë	Automjet	2;
ë) zbarkim të mjeteve mbi 3,5 tonë	Automjet	2.

KAPITULLI 3 TARIFA TË TJERA

3. TARIFAT MAKSIMALE PËR AGJEN-CITË DETARE, FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM DHE ENERGJI ELEKTRIKE

3.1 Komisioni i agjencive për shërbimin e vjeljes së taksës portuale

Kjo tarifë përcaktohet në kontratë ndërmjet portit dhe agjencisë, por nuk duhet të jetë më e madhe se 2%.

3.2 Tarifatat e shërbimit për furnizim me ujë të pijshëm.

Kur furnizimi i anijes bëhet nga bregu i detit tarifa e shërbimit është 20% mbi çmimin (vlerën) e ujit të furnizuar.

3.3 Komisioni me furnizim me energji elektrike

Kur furnizimi i anijes bëhet nga kalata e portit komisioni është 15% mbi vlerën e faturës së energjisë së furnizuar.

3.4 Tarifa për shërbimin e heqjes së plehrave për çdo ditë është:

	Për një ditë
a) për anijet deri në dhe përfshirë 500 (GT)	€ 5;
b) për anijet 501 deri në dhe përfshirë 1,000 (GT)	€ 8;
c) për anije mbi 1,001 deri në 3,000 GT	€ 13;
d) për anije nga 3,001 deri në 6,000 GT	€ 18;
e) për anije nga 6,001 deri në 10,000 GT	€ 19;



ë) për anije nga 10,001 deri në 15,000 GT	€	21;
f) për anije nga 15,001 deri në 20,000 GT	€	24;
g) për anije mbi 20,000 GT	€	30.

Për anijet RO-RO të udhëtarëve kur kanë deri në 200 udhëtarë, për çdo 50 udhëtarë 15 € dhe kur kanë mbi 200 udhëtarë, 10 € për çdo 50 udhëtarë.

Kur shërbimi kryhet në radë ose në pontilin e karburantit, pagesa rritet me 100%.

Kur me kërkesë të kapitenit kërkohet mbi një shërbim në ditë, tarifa rritet me 50%.

KAPITULLI 4 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

4.1 Me hyrjen në fuqi të këtij akti, urdhri i përbashkët i ministrisë përgjegjëse për transportin nr. 4227, datë 8.9.2003 dhe Ministrisë së Financave nr. 3476/6, datë 9.9.2003, shfuqizohet.

4.2 Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCIVE
Arben Ahmetaj

VENDIM Nr. 37, datë 30.6.2016 NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 5.5.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 9 Akti, që i përket:

KËRKUES: Zaim Rexha

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Dervish Sekniqi, Agim Tufi, Vildan Tufi, Syrri Dizdari, Mensur Nehani, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 66, datë 27.2.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuar në vitin 1993 ka blerë nga shtetasi H.U. një pronë të paluajtshme, të përbërë nga një sipërfaqe truall 160 m² dhe shtëpia e ndërtuar mbi të, me sipërfaqe 73.9 m², të cilën e ka regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 313/1993. Në vitin 2007 ai i është drejtuar Zyres Vendore për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Shkodër për regjistrimin e pronës në sistemin e ri të regjistrimit. ZVRPP-ja, me aktin nr. 485 prot., datë 2.4.2007, ka vendosur refuzimin e regjistrimit me arsyetimin se pasuria figuronte pa kufij dhe pa sipërfaqe të pronës dhe se kërkuar nuk dispononte deklaratat e kufitarëve.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuar i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi me objekt detyrimin e ZVRPP-së për të regjistruar pasurinë, padi e cila është pranuar pjesërisht me vendimin nr. 1459, datë 28.5.2010.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 66, datë 27.2.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të kërkuarit.



4. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit rekursët e paraqitura nga kërkuesi dhe ZVRPP-ja, me vendimin nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, ka vendosur mospranimin me arsyetimin se nuk përmbanin asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.

II

5. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 4.11.2015, duke pretenduar se procesi i zhvilluar në gjykatat e zakonshme nuk ka respektuar standardet që lidhen me procesin e rregullt ligjor, për rrjedhojë atij i është cenuar e drejta e pronësisë. Në mënyrë të përmbledhur kërkuesi parashtron se është cenuar:

5.1 *E drejta për t'u dëgjuar* dhe për të parash-truar prova e argumente në lidhje me çështjen, pasi Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka respektuar orarin e caktuar me shpallje për zhvillimin e seancën gjyqësore civile.

5.2 *E drejta e aksesit* në Gjykatën e Lartë, pasi ndonëse pretendimet për shkelje procedurale gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Shkodër ishin parashtruar në recurs, Kolegji Administrativ vendosi mospranimin e recursit në dhomën e këshillimit.

5.3 *Parimi i gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi Gjykata e Apelit Shkodër duhet t'i kishte dhënë përparësi koordi-nimit të orarit të publikuar me shpallje me atë të shënuar në dosje, por duke gjykuar të gjitha rrethanat e çështjes, shkëlja ka qenë e qëllim-shme.

5.4 *Standardi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm*, pasi edhe pse çështja kishte natyrë administrative jo komplekse, bazë ligjore të qartë, si dhe sjellje aktive të kërkuesve, procesi gjyqësor ka zgjatur gati 10 vjet. Për sa i takon sjelljes së palëve të pa-ditura, ajo nuk ka qenë korrekte, kurse veprimtaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka qenë jashtëzakonisht e pakoordinuar, duke kryer veprime procedurale në kundërshtim me thelbin e gjykimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushte-

tues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tij janë paraqitur brenda afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30/2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*sib vendimet nr. 48, datë 6.7.2015; nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe atë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ai legjitimohet t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në Gjykatën e Apelit Shkodër

9. Kërkuesi ka pretenduar se mosrespektimi nga Gjykata e Apelit Shkodër i orarit të caktuar me shpallje për zhvillimin e seancën gjyqësore civile dhe zhvillimi i procesit gjyqësor pa praninë e tij, edhe pse ai ka qenë i pranishëm dhe në pritje në ambientet e gjykatës, i ka mohuar të drejtën për të mbrojtur pretendimet e tij, dhe për të parashtruar prova e argumente në lidhje me interesat e tij ligjorë në çështjen konkrete.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që



cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendim-marrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 31, datë 26.5.2014; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për efekte të këtij gjykimi, veçanë-

risht referuar listës së shpalljes së çështjeve për shqyrtim në muajin shkurt 2012 nga Gjykata e Apelit Shkodër, rezulton se seanca gjyqësore civile ishte caktuar të zhvillohej në orën 9:30. Po ashtu, Gjykata vëren se në kapakun e dosjes gjyqësore si orë të zhvillimit të seancës është shënuar me shkrim dore ora 9:00, kurse sipas procesverbalit të seancës konstatohet se ajo ka filluar në orën 9:18 dhe ka përfunduar në orën 9:25. Në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 27.2.2012 pasqyrohet fakti se kërkuesi (edhe disa nga personat e tretë) u thirr dhe nuk u paraqit, prandaj gjykata ka vendosur ta zhvillojë gjykimin e çështjes në mungesë të tyre, duke qenë se ata kanë marrë dijeni për ditën dhe orën e gjykimit me shpallje dhe pa ndonjë shkak të ligjshëm nuk janë paraqitur. Po ashtu, Gjykata vëren se gjatë seancës gjyqësore është lexuar fillimisht kërkesa ankimore e paraqitur nga pala e paditur, ZRPP-ja, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, më pas procesi ka vijuar me leximin e ankimit dhe apelit kundërshtues të kërkuesit, dhe në përfundim gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që kishte pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, duke urdhëruar ZRPP-në të regjistronte një pjesë të pasurisë që nuk krijonte mbivendosje.

13. Gjykata, bazuar në rrethanat e mësipërme, vlerëson se Gjykata e Apelit Shkodër, duke zhvilluar seancën gjyqësore në një orar të ndryshëm nga ai i njoftuar kërkuesit sipas listës së shpalljes, i ka cenuar këtij të fundit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Gjykata çmon se thjesht dhe vetëm leximi nga Gjykata e Apelit Shkodër i përmbajtjes së ankimit dhe apelit kundërshtues të paraqitur nga kërkuesi nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar të përmbushur detyrimin që buron nga parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Gjykata rithekson se thjesht prania fizike e palëve gjatë procesit civil nuk është e mjaftueshme, sepse është gjyqtari që gjatë gjykimit që duhet t'u japë mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre.

14. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundim se për sa kohë kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm në seancën gjyqësore, për shkak të zhvillimit të saj në një orar të ndryshëm nga ai i njoftuar zyrtarisht me shpallje, pretendimi për cenimin e parimit të



barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i bazuar.

15. Gjykata rithekson se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 5, datë 25.2.2013; nr. 42, datë 7.7.2014; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata e ka vlerësuar si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rastin kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata, në vështrim të standardeve të mësipërme, po ashtu nisur nga përfundimi për mosgarantimin e barazisë substanciale të palëve nëpërmjet një kontradiktoriteti efektiv midis tyre në procesin gjyqësor civil të zhvilluar nga Gjykata e Apelit Shkodër, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se kjo parregullsi nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë, vlerëson se kjo e fundit ka lejuar cenimin e aksesit për kërkuesin. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e procesit të rregullt në Gjykatën e Lartë është i bazuar.

18. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, që lidhen me cenimin e parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme, si dhe me mosgjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshem, Gjykata vlerëson se ato nuk janë ngritur në nivel kushtetues, për rrjedhojë kërkuesi nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues në lidhje me to.

19. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kush-tetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 66, datë 27.2.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë¹.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 38, datë 6.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

¹ Gjyqtarët V. Kristo dhe F. Lulo votuan vetëm për shfuqizimin e vendimit nr. 00–2014–3102, datë 9.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.4.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 4 Akti, që i përket:

KËRKUES: Viktori Qirjazi, Brikena Qirjazi, Qirjako Qirjazi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Artan Treska, Etleva Goga (Maliqi), Florika Maliqi

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-(384), datë 23.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 41, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjektet e interesuara (A. Treska etj.) kanë paraqitur një padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, duke paditur kërkuësit, prej të cilëve kanë kërkuar: njohjen si bashkëtrashëgimtarë në $\frac{3}{4}$ -at pjesë të truallit me sipërfaqe 900 m², të ndodhur në qytetin e Korçës, të pasurisë së ish-pronares P.M., të njohur, të kthyer e të kompensuar me vendimin nr. 275, datë 2.5.2003 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Korçë (në vijim “KKKP”) dhe me vendimin nr. 632, datë 21.4.1995, të KKKP-së Korçë; dorëzimin e pjesës përkatëse të kësaj pasurie trashëgimore, duke urdhëruar subjektin e interesuar, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Korçë (në vijim “ZVRPP”), të bëjë regjistrimin e $\frac{3}{4}$ -ve pjesë të pasurisë trashëgimore në emër të tyre.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41–2010–3174 (2000), datë 30.7.2010, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurve, Viktori Qirjazi, Brikena Qirjazi, Qirjako Qirjazi, të njohin

bashkëpronarë për shkak të trashëgimisë paditësit Artan Treska, Etleva Gogo, Florika Maliqi mbi pasurinë e paluajtshme të regjistruar në ZRPP-në Korçë me nr. 5/276 pasurie, zona kadastrale nr. 8563, vol.19, faqe 232, me sipërfaqe 900 m², e ndodhur në Korçë në rrugën “Papa Kristo Negovani” e më konkretisht të dorëzojnë pjesën prej 202.8 m² nga ky truall. Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera të saj. Regjistrimin e këtij vendimi gjyqësor dhe të disponimeve të tij në ZRPP-në Korçë pasi të marrë formë të prerë.”

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 530, datë, 20.12.2010, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 2000, datë 30.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për sa i përket pjesës së rrëzuar të padisë së paditëseve, Artan Treska, Etleva Gogo dhe Florika Maliqi. Ndryshimin e pjesës tjetër të këtij vendimi si më poshtë: rrëzimin e padisë së paditëseve për sa i përket kërimit për pasurinë trashëgimore në emër të trashëgimlënësës Dhimitra Maliqi.”

4. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, kanë ushtruar rekurs Artan Treska, Etleva Gogo dhe Florika Maliqi. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2012–240, datë 8.2.2012, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Artan Treska, Etleva Gogo dhe Florika Maliqi kundër vendimit nr. 530, datë 20.12.2010 të Gjykatës së Apelit Korçë.”

5. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 55, datë 3.6.2014, ka vendosur: “Shfuqizimin e vendimit nr. 240, datë 8.2.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.”

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2015–(384), datë 23.9.2015, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 41–2010–3174 (2000), datë 30.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe të vendimit nr. 530, datë 20.12.2010 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe pranimin e padisë së palës paditëse Artan Treska dhe Etleva Gogo (Maliqi).”

II

7. **Kërkuësit** i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të kërkesës, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

7.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi duke



ndryshuar faktet dhe rrethanat ka kaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Ai ka arritur në përfundime të ndryshme nga dy gjykatat më të ulëta, duke u kthyer në gjykatë fakti dhe jo ligji.

7.2 Nuk është respektuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor. Ai është kontra-diktor dhe jologjik. Në arsyetim ka kundërthënie, gjë që e bën vendimin të cenueshëm.

8. **Subjektet e interesuara** kanë parashtruar se:

8.1 Pretendimi i kërkuarve se nuk është respektuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj nuk është i bazuar, pasi gjykata nuk ka shtrembëruar faktet dhe nuk ka marrë fakte të reja, por mbi bazën e fakteve të mbledhura dhe të pranuar nga gjykatat e faktit ka arritur në një përfundim të ndryshëm.

8.2 Nuk është i bazuar as pretendimi për mosarsyetimin e vendimit nga ana e Kolegjit Civil, pasi ky Kolegj ka dhënë të gjitha argumentet e nevojshme lidhur me zbatimin e ligjit për konfliktin konkret. Kërkuarët janë përpjekur të ngatërrojnë gjykatën duke lidhur dorëzimin e sendit me çështjen e ligjit të zbatueshëm në rastin e trashëgimisë. Dorëzimi i sendit, siç ka pranuar edhe Gjykata e Lartë, nuk mund të bëhet pa u bërë pjesëtimi midis bashkëpronarëve dhe është i shkëputur nga ky gjykim konkret.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarve

9. Kërkuarët legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se në përmbajtjen e kërkesës evidentohen pretendimet për cenimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Për rrjedhojë, kërkuarët legjitimohen *ratione materiae*.

11. Gjykata rithekson se ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të

rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për cenimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë

12. Kërkuarët pretendojnë se nuk është respektuar standardi kushtetues i arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil. Ai është kontradiktor dhe jologjik. Sipas tyre, në arsyetim ka kundërthënie, gjë që e bën vendimin të cenueshëm.

13. Gjykata ka theksuar se në funksion të garantimit të së drejtës së aksesit është e një rëndësie thelbësore respektimi i standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsytimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 82, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).



5. Referuar vendimit të Kolegjit Civil rezulton se në pjesën hyrëse ai përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit kanë paraqitur rekurs subjektet e interesuara. Po ashtu, vendimi i Kolegjit Civil pasqyron në pjesën hyrëse të gjitha shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesit. Gjithashtu, Kolegji Civil, mbi pretendimin kryesor të kërkuesve për interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit lidhur me kontratën e dhurimit dhe radhën e trashëgimlënësës, ka konkluduar se ky pretendim është i bazuar, duke dhënë edhe argumentet përkatëse, gjë që është në kompetencë të atij Kolegji. Kështu, ai ka argumentuar se “*në interpretim të nenit 364 të Kodit Civil, në të cilin parashikohet se në radhë të tretë thirren në trashëgim ndërmjet të tjerësh vëllezërit dhe motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, ky Kolegj vlerëson se në rastin në gjykim, për sa kohë që H.M. ka vdekur para trashëgimlënësës O.M. (motra e nënës së tij), e drejta për pjesën takuese duhet t’u kalojë trashëgimtarëve të tij ligjorë paditësve A.T. dhe E.G. fëmijët të tij, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta me të paditurën V.Q. Kështu, A.T dhe E.G u kalon nga 1/4 pjesë takuese, ndërsa V.Q. 2/4 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësës O.M.*” (§.30 i vendimit).” Mbi këtë bazë ai ka konkluduar se gjykata e rrethit duhej të kishte pranuar tërësisht padinë e subjekteve të interesuara.

16. Sipas nenit 472/1 dhe 472/ 2 të KPC-së, rekursi mund të bëhet edhe kur: a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji dhe b) ka shkelje të rënda të normave procedurale. Duke iu referuar vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, rezulton se ai ka argumentuar mjaftueshëm se përse gjykatat e faktit kanë keqzbatuar ligjin, duke tejkaluar përcaktimet kontraktuale, që përbëjnë ligj për palët. Në rastin konkret, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka dhënë arsye për pranimin e padisë, duke përmendur edhe pretendimet e rekursuesve, sipas udhëzimeve të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 55/2014 lidhur me këtë çështje, gjë që e bën vendimin të rregullt në formë, të qartë në përmbajtje dhe tërësisht të arsyetuar.

17. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë plotëson të gjitha kriteret e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të

nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

18. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesve në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

19. Kërkuesit kanë pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi duke ndryshuar faktet dhe rrethanat ka kaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Ai ka arritur në përfundime të ndryshme nga dy gjykatat më të ulëta, duke u kthyer në gjykatë fakti dhe jo ligji.

20. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit



në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtëm të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 1, datë 29.1.2016; nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkëljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë. Neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016; vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu referuar çështjes konkrete, Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë prova të reja. Ai Kolegj, mbi të njëjtat fakte dhe rrethana të mbledhura nga gjykatat e faktit, ka bërë interpretim të ndryshëm të dispozitave të Kodit Civil që lidhen me radhën e trashëgimtarëve ligjorë, duke arritur në përfundimin se edhe subjektet e interesuara duhet të njihen bashkëpronarë të pasurisë së lënë nga trashëgimlënësja. Në fund, Kolegji ka vendosur pranimin tërësisht të padisë. Në këto kushte, Gjykata çmon se Kolegji Civil ka vepruar brenda kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe ligji procedural civil.

24. Nisur nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se edhe ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/ 1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash²,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 39, datë 6.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha,	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 4.5.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 24 Akti që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Podgorica 2000” sh.p.k., përfaqësuar nga Sami Podgorica

² Gjyqtari V. Kristo votoi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 35, datë 27.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese.



SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00–2015–1586 (221), datë 29.4.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, shoqërisë “Podgorica” sh.p.k., që kërkoji pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që kërkoji rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Sipas akteve bashkëlidhur kërkesës rezultoi se mes shoqërisë “Podgorica 2000” sh.p.k. dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është lidhur kontrata e qirasë e datës 12.6.2000, me objekt dhënien me qira nga kjo e fundit të një objekti 3-katesh në Qendrën Hidrotermale Llixha Elbasan, me një sipërfaqe 3000 m², nga të cilat 1.432 m² sipërfaqe nën objekt dhe 2276 m² sipërfaqe funksionale.

2. METE, me shkresat e datave 27.6.2005, 16.8.2005 dhe 14.10.2005, i ka kërkuar shoqërisë “Podgorica 2000” sh.p.k. zgjidhjen e kontratës dhe shlyerjen e qirasë së prapambetur.

3. Në datën 7.2.2006 rezultoi se është marrë në dorëzim objekti, hotel i ri, pronë e shtetit, dhënë me qira kërkuases (pala e paditur në procesin gjyqësor). Po në këtë datë METE (pala paditëse e kundërpaditur në procesin gjyqësor) ka kërkuar gjyqësisht që të llogaritet dhe të paguhet vlera e prapambetur e qirasë së truallit dhe e ndërtesës në masën 9.487 USD dhe 810.297 lekë. Kërkesja ka paraqitur kundërpadi me objekt detyrimin e paditësit të kundërpaditur t’i paguajë asaj vlerën e punimeve të kryera në truallin, sipërfaqe funksionale 2276 m² në vlerën 9.759.698 lekë.

Faqe | 10388

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2480, datë 30.3.2009, ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur kundërpaditëse shoqëria “Podgorica 2000” sh.p.k. t’i paguajë paditësit të kundërpaditur METE vlerën e qirasë së ndërtesës së papaguar deri në datën 6.2.2006, në vlerën 9,487 USD, si dhe detyrimin e palës paditëse të kundërpaditur, METE, t’i paguajë të paditurit kundërpaditës, shoqërisë “Podgorica 2000” sh.p.k., vlerën e punimeve të kryera në truallin, sipërfaqe funksionale 2276 m² në vlerën 9.759.698 (nëntë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.”*

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1121, datë 15.6.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2480, datë 30.3.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2015–1586 (221), datë 29.4.2015, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 1121, datë 15.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, lidhur me kundërpadinë. Lënien në fuqi të vendimit nr. 1121, datë 15.6.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë për pjesët e tjera.”*

II

7. **Kërkesja, shoqëria “Podgorica 2000” sh.p.k.**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

7.1 Është mohuar e drejta e mbrojtjes dhe e përfaqësimit të interesave të kërkuases, pasi ajo nuk ka pasur dijeni për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë (as në dhomën e këshillimit, as në seancë), për shkak të moskomunikimit të rekursit së Avokaturës së Shtetit. Në dosjen gjyqësore gjendet dëftesa e komunikimit të rekursit me shënimin e avokatit mbrojtës “nuk jam më avokat i kësaj çështjeje”.

7.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit është ekzekutuar që në datën 8.7.2014.

8. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, kundërshton pretendimet e kërkuases në këto drejtime:

8.1 Kërkesja nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.



Vendimi i Gjykatës së Lartë që ka rikthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit nuk mund të konsiderohet si një vendim përfundimtar për efektet e gjykimit kushtetues, pasi nuk vendos në mënyrë përfundimtare mbi çështjen. Në të tilla raste kërkesja i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të saj juridike gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë edhe mbrojtjen kushtetuese pranë kësaj Gjykate.

8.2 Nuk kemi cenim të procesit të rregullt ligjor. Kërkesja nuk ka arritur të provojë pretendimet e saj për mungesën e komunikimit të rekursit. Në dosjen gjyqësore gjendet e administruar dëftesa e komunikimit të rekursit e nënshkruar nga avokati mbrojtës. Njëkohësisht është administruar edhe prokura me anë të së cilës kërkesja autorizon avokatin për ta përfaqësuar në të tria shkallët e gjyqësorit. Në dosjen gjyqësore nuk gjendet i administruar asnjë akt noterial për revokimin e kësaj prokure ose ndonjë akt që të vërtetojë heqjen dorë të përfaqësuesit nga gjykimi i kësaj çështjeje. Gjithashtu, njoftimin për këtë çështje Gjykata e Lartë e ka bërë me shpallje.

8.3. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Neni 485/a i KPC-së parashikon zgjidhjen e pasojave kur nga Gjykata e Lartë prishet vendimi, i cili është ekzekutuar tërësisht apo pjesërisht, duke parashikuar detyrimin e personit që ka përfituar të kthejë të gjitha përfitimet e marra nga ekzekutimi i vendimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesses

9. Kërkesja legjitimohet *ratione personae*, pasi parashikohet si subjekt nga neni 134/1/g i Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në kushtet e dhënies së një vendimi që ka vendosur rikthimin e çështjes për rigjykim, fillimisht duhet të analizohet çështja e legjiti-

mimit të kërkuesses në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, lidhur me shterimin e të gjitha mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përpara paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

11. Gjykata ka theksuar se, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individit përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'i jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka theksuar se neni 131/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkesi të ketë shteruar mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor.



Dhunimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelit dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në raste analoge Gjykata është shprehur se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare mbi themelin e çështjes. Me fjalë të tjera, vendime të këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, nuk mund të quhen përfundimtare, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese pranë kësaj Gjykate (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk legjitimohet për t'ju drejtuar kësaj Gjykate pasi nuk ka shteruar mjetet ligjore në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar)

MENDIMI PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje për rrëzim të kërkesës dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Shumica është shprehur se: “Në rastin objekt gjykimi, Gjykata e Lartë e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si përfundimtare për efekt të gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare mbi themelin e çështjes. Me fjalë të tjera vendime të këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, nuk mund të quhen përfundimtare në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese pranë kësaj Gjykate” (§ 14 i vendimit).

3. Ashtu sikundër shumica eidenton, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00–2015–1586, datë 29.5.2015, e ka kthyer çështjen për rishqyrtim në po të njëjtën gjykatë të Apelit, por me tjetër trup gjykues, lidhur me kundërpadinë (§ 6 i vendimit).

4. Kërkuesja pretendon para Gjykatës cenimin e procesit të rregullt ligjor për shkak të mungesës së mbrojtjes efektive me përfaqësues në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

5. Bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

6. Gjatë jurisprudencës së saj, Gjykata ka theksuar se shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 15, datë 18.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i



cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetohet se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, kërkesja nuk kishte mjet tjetër ankimi efektiv, përveçse në Gjykatën Kushtetuese, dhe në kushtet kur ajo pretendon proces të parregullt ligjor vetëm nga procesi i zhvilluar nga Gjykata e Lartë, kjo përbën mjaftueshëm shkak për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Kushtetuese për pranimin ose rrëzimin e kërkesës, pra për rrjedhojë edhe për vënien në vend të së drejtës së saj për mbrojtje efektive me përfaqësues ligjor.

8. Mendoj se në rastet e kthimit për rigjykim nga Gjykata e Lartë, çështja duhet parë rast pas rasti, pasi nëse vetë gjykimi në Gjykatën e Lartë shoqërohet me shkelje të procesit të rregullt ligjor, ato mbeten të paverifikuara dhe të pakorrigjuara nga Gjykata Kushtetuese. Konkluzioni dhe qëndrimi i shumicës *a priori* se mjafton që çështja të jetë kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë dhe kjo nuk përbën objekt gjykimi kushtetues, vjen në kundërshtim jo vetëm me nenin 131/f të Kushtetutës dhe nenin 30/2 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, pasi kërkuesi i ka shtuar mjete e ankimit në të tria shkallët e gjykimit, por edhe me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Kjo për faktin se, sipas qëndrimit të shumicës, Gjykata e Lartë mund ta kthejë disa herë për rigjykim çështjen, duke tejzgjatur procesin dhe ky lloj vendimi nuk ka asnjë mjet tjetër për t'u kontrolluar (në rastin konkret ankimi në Gjykatën Kushtetuese), ndërkohë që vetë ky vendim i kthimit për rigjykim mund të jetë marrë në kundërshtim me procesin e rregullt ligjor.

9. Prandaj edhe në kuptimin kushtetues, interpretimi që i bën shumica shterimit të mjeteve, të cilin e lidh me një gjykim përfundimtar për themelin e çështjes, i kufizon aksesin kërkueses për mbrojtje efektive të së drejtës për proces të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës.

10. Për sa më lart, mendoj se pavarësisht se për themelin çështja kishte kaluar për rigjykim

pranë Gjykatës së Apelit, kërkesja e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve sipas nenit 131/f të Kushtetutës, për rrjedhojë vendimi nr. 00–2015–1586, datë 29.5.2015, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duhej parë nga shumica në drejtim të respektimit të standardeve për proces të rregullt ligjor, nëse qëndrojnë pretendimet e saj për mungesën e mbrojtjes efektive në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

Kryetar: Bashkim Dedja

VENDIM

Nr. 40, datë 6.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.4.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 2 Akti që i përket:

KËRKUES: Fatmir (Gazmir) Zeneli

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 118, datë 19.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 148, datë 26.9.2000, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 26, datë 17.1.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të



kërkuesit, Fatmir Zeneli, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është hetuar në mungesë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila në përfundim të hetimeve ka dërguar për gjykim çështjen penale me akuzën e kryerjes së veprave penale “Vrasje me paramendim për motive të dobëta” të shtetasit L.H., “Vrasje me dashje” të shtetasit A.C., “Vrasje e mbetur në tentativë” në dëm të shtetasit D.P.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 118, datë 19.7.2000, ka vendosur *inter alia* deklarinin fajtor të kërkuesit, Fatmir (Gazmir) Zeneli, për kryerjen e veprave penale “Vrasje me paramendim”, të shtetasit L.H., “Vrasje me dashje”, të shtetasit A.C., “Plagosje të rëndë”, të shtetasit D.P., dhe “Armëmbajtje pa leje”, duke e dënuar atë përkatësisht në bazë të nenit 78/1 të Kodit Penal (KP-së) me 25 vjet burgim, në bazë të nenit 76 të KP-së me 20 vjet burgim, në bazë të nenit 88/1 të KP-së me 10 vjet burgim dhe në bazë të nenit 278/2 të KP-së me 2 vjet burgim. Përfundimisht, në bazë të nenit 55 të KP-së e ka dënuar kërkuesin me 25 vjet burgim.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 148, datë 26.9.2000, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 118, datë 19.7.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për sa i përket vrasjes së shtetasit L.H., duke e deklaruar kërkuesin Fatmir Zeneli fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim dhe në bazë të nenit 78/2 të KP-së e ka dënuar atë me burgim të përjetshëm. Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për sa i përket vrasjes së shtetasit A.C., plagosjes së shtetasit D.P. dhe armëmbajtjes pa leje. Përfundimisht, kërkuesi në bazë të nenit 55 të KP-së është dënuar me burgim të përjetshëm.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 26, datë 17.1.2001, mbi bazën e rekursit të bërë nga përfaqësuesi i kërkuesit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi ai nuk përmbante

shkaqe si ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penal (KPP).

5. Kërkuesi në të tria shkallët e gjykimit është gjykuar në mungesë dhe interesat e tij në gjykim i ka mbrojtur avokati i caktuar nga familjarët e tij. Në datën 17.8.2015, ai është ekstraduar nga shteti grek dhe u është dorëzuar autoriteteve shqiptare mbi bazën e një urdhri ekzekutimi për dënimin e dhënë për të dhe ka filluar vuajtjen e dënimit.

II

6. **Kërkuesi, Fatmir Zeneli** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

6.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit si dhe të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, pasi kërkuesi nuk ka marrë dijeni efektive për procesin penal në ngarkim të tij. Nga ana e gjykatës nuk është bërë asnjë njoftim formal për thirrjen e tij, duke mos përmbushur detyrimet që burojnë nga KPP-ja.

6.2 Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka kryer njoftimet për kërkuesin (në cilësinë e të pandehurit), si dhe e ka zhvilluar gjykimin pa deklaruar mungesën e tij. Gjithashtu, kjo gjykatë ka administruar në gjykim ankimin e bërë nga familjarët e tij në kundërshtim me ligjin procedural.

6.3 Gjykimi në apel është zhvilluar në prani të avokatit XH.P., pa u verifikuar më parë tagrat e përfaqësimit të tij dhe vlefshmëria e aktit të përfaqësimit që gjendej në dosje.

6.4 Në dhënien e vendimit Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka përmendur akuzat e reja të përdorura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nuk është shprehur pse ka rënduar pozitën e të pandehurit pavarësisht mospërdorimit në akuzë të neneve të shtuara.

6.5 Gjykata e Lartë është investuar për rekursin e paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët në kundërshtim me nenin 410 të KPP-së, duke ezauruar kështu të drejtën e kërkuesit për ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

6.6 Edhe pse në rekursin e paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur prej familjarëve të kërkuesit janë paraqitur të gjitha shkeljet e kryera nga



gjykatat më të ulëta, vendimi i mospranimit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, por pa arsyetuar vendimin e saj.

7. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka kundërshtuar pretendimet e kërkuarit në këto drejtime:

7.1 Kërkuari nuk ka shteruar më parë mjetet e nevojshme të ankimit të parashikuara nga KPP-ja, ligji nr. 8322, datë 2.4.1998, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë...”, si dhe ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, neni 51 i tij.

7.2 Pretendimi i kërkuarit në lidhje me mungesën e arsytimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit, është i pabazuar, pasi ky vendim është i arsyetuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Gjykata paraprakisht vlerëson të analizojë prapësimin e subjektit të interesuar për moslegjitimitimin e kërkuarit pasi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Sipas Prokurorisë së Përgjithshme kërkuari, si i gjykuar në mungesë, mund të paraqesë kërkesë përpara juridiksionit kushtetues vetëm pasi të ketë përfunduar procesi gjyqësor i rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit.

9. Në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuarin që për zgjidhjen e çështjes së tij t'iu drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kërkuari legjitimohet vetëm kur shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se ai duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore

shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se neni 131/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar prej saj, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuari të ketë shteruar mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimet nr. 15, datë 18.4.2007, nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Çështja e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion nga i gjykuari në mungesë është trajtuar gjerësisht edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ-ja), e cila mban qëndrimin se Konventa u lë shteteve kontraktuese diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjetit të parashikuar për të garantuar se sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me dispozitat e nenit 6. Në veçanti, mjetet procedurale, të ofruara nga e drejta dhe praktika e brendshme, duhet të tregojnë se janë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur e për t'u mbrojtur vetë dhe nuk ka kërkuar t'i shmanget gjykimit (*shih Sejdovic kundër Italisë, [DHM], nr. 56581/00, § 83, 1 mars 2006*). Ndonëse GJEDNJ-ja nuk përcakton shprehimisht mjetin procedural efektiv për rivendosjen e të drejtave të pretenduara si të cenuara, në jurisprudencën e saj mbizotëron qëndrimi se detyrimi i ankuesve është pikërisht shterimi i mjeteve të brendshme ligjore, të cilat janë të vlefshme në teori dhe praktikë, në periudhën përkatëse, të aksesueshme, që mund të sigurojnë ndreqjen e ankimeve të tyre dhe që ofrojnë perspektiva të arsyeshme suksesi (*shih Sejdovic kundër Italisë, § 46*). Për më tepër, vlerësimi nëse janë shteruar mjetet e brendshme ligjore, normalisht bëhet duke iu referuar datës në të cilën është depozituar ankimi në gjykatë. Megjithatë ky rregull përbën një përjashtim, i cili mund të justifikohet nga rrethanat specifike sipas rastit (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).



12. GJEDNJ-ja ka theksuar se në rast se gjenden disa mjete ligjore, të cilave mund t'u referohet aplikanti, ai është i lirë të zgjedhë mjetin që trajton ankimin e tij/e saj (*shih Croke kundër Irlandës, nr. 33267/96, 15 qershor 1999*). Me fjalë të tjera, kur mjeti ligjor është zgjedhur, nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër që në esencë ka të njëjtin qëllim (*shih Moreira Barbosa kundër Portugalisë, nr. 65681/01, 2004–V*). Ajo ka theksuar gjithashtu se ankimi para Gjykatës Kushtetuese është një mjet ligjor efektiv për të kundërshtuar një dënim në mungesë (*shih Shkalla kundër Shqipërisë, §§ 59-62, 10 gusht 2011*).

13. Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese, në rastet e gjykimit në mungesë në të gjitha shkallët e gjykimit mjeti efektiv në dispozicion të kërkuesit është paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi që do të verifikojë nëse autoritetet kanë respektuar rregullat procedurale dhe kanë marrë të gjitha masat ligjore për njoftimin e rregullt të kërkuesit për procesin gjyqësor të filluar ndaj tij. Në raste të tilla kërkuesit nuk i kërkohet shterimi i mjeteve të tjera ligjore, siç është kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë apo paraqitja e kërkesës për rivendosjen në afat. Në kushtet kur proceset gjyqësore në ngarkim të kërkuesit janë përfunduar në të tria shkallët e gjykimit, paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është mjeti efektiv që ofron mundësitë e arsyeshme për rivendosjen e të drejtave të pretenduara, duke kundërshtuar dënimin in absentia (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura në kërkesë *prima facie* janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata, bazuar në aktet e administruara në dosjen e çështjes, vëren se kërkuesi është njohur me vendimin penal nr. 148, datë 26.9.2000, të Gjykatës së Apelit Vlorë përmes njoftimit të datës 17.8.2015, kur është ekzekutuar urdhri i datës 14.11.2000 i prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rrjedhimisht, duke qenë se data e fillimit të afatit dy vjeçar, brenda të cilit kërkuesi mund të paraqesë një ankim kushtetues, është 17.8.2015

dhe kërkesa në Gjykatën Kushtetuese mban datën 20.10.2015, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

15. Në përfundim, Gjykata vlerëson se prapësimi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, në lidhje me mungesën e legjitimitit të kërkuesit të gjykuar në mungesë, është i pabazuar.

B. Për pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit

16. Kërkuesi pretendon se nuk ka marrë dijeni efektive për procesin penal në ngarkim të tij si rezultat i mospërbushjes nga ana e autoriteteve të detyrimeve që burojnë nga KPP-ja për njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet. Nga ana e gjykatës nuk është bërë asnjë njoftim formal për thirrjen e tij, duke mos përmbushur detyrimet që burojnë nga KPP-ja. Për rrjedhojë, ai pretendon se i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për t'u mbrojtur, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

17. Gjykata ka konsoliduar qëndrimin se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë, që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. E drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimin nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin e gjykimit në mungesë është detyrë e autoriteteve publike që të informojnë të pandehurin nëse ka ose jo një procedim penal në ngarkim të tij, pasi vetëm kështu mund të arrihet



siguria se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Në këtë mënyrë duhet që autoritetet shtetërore të marrin të gjitha masat e nevojshme për të informuar të pandehurin dhe vetëm nëse janë të sigurt se ai ka marrë njoftim në formën që parashikon ligji, atëherë mund të vazhdohet me procedimin në mungesë. Ndaj është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimin nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo rast, synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimin nr. 23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Caktimi i mbrojtësit në procesin penal në kushtet dhe mënyrat e parashikuara në ligj, përfshirë dhe atë të caktuar kryesisht nga gjykata, nuk ka për qëllim vetëm pjesëmarrjen e tij në një shkallë të gjykimit, por ndjekjen e çështjes nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit dhe pjesëmarrjes në të, deri në instancën më të lartë gjyqësore, për të mbrojtur plotësisht të drejtat e të pandehurit në një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjithashtu, Gjykata në praktikë të vazhdueshme nuk ka pranuar pretendimet e individit për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në garantimin e këtyre standardeve (*shih vendimet nr.*

49, datë 29.9.2014, nr. 40, datë 22.9.2011, nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Kërkuesi ka pretenduar se gjykimin në mungesë është realizuar në prani të një avokati të zgjedhur nga familjarët e tij, i cili nuk përfaqëson vullnetin e tij, në kundërshtim me rregullat procedurale. Për më tepër, kërkuesi ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, përfaqësuesi i tij ka qenë pa tagra përfaqësimi.

23. Gjykata, bazuar në materialet e administruara në dosjen gjyqësore, vëren se për kërkuesin ka dy vendime për mosgjetjen e tij, një të prokurorit të çështjes dhe një të oficerit të Policisë Gjyqësore ku shprehet se “i akuzuari është larguar në drejtim të paditur, ai është kërkuar në banesën e tij dhe se nga të dhënat operative rezulton se është larguar [...]”. Pas kësaj njoftimi i materialeve të çështjes, njoftimi i akuzës dhe i dërgimit të çështjes në gjyq i janë komunikuar Dhomës së Avokatisë, duke iu referuar avokatit të caktuar kryesisht. Gjithashtu, edhe për zhvillimin e seancave gjyqësore me të akuzuar kërkuesin, njoftimet i janë dërguar Dhomës së Avokatisë, duke iu referuar avokatit të caktuar kryesisht. Me aktmarrëveshjen e datës 30.7.1998 rezulton se kunati i kërkuesit ka kërkuar që interesat e tij në të gjitha shkallët e gjykimit të përfaqësohen nga avokat Xh.P., i cili ka vijuar me përfaqësimin e kërkuesit në procesin gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas të gjitha njoftimet për seancat gjyqësore i janë drejtuar këtij avokati. Gjithashtu, nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se është po ky avokat, i cili pas dhënies së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe ka paraqitur edhe rekurs në Gjykatën e Lartë.

24. Nenet 140/1, 141 dhe 142 të KPP-së përcaktojnë rregullat për njoftimin e të pandehurit dhe organet kompetente, me qëllim sigurimin e një procesi të rregullt ligjor për të pandehurin. Nga rrethanat e parashtruara më lart, Gjykata vëren se nga faktet e shqyrtuara nuk konstatohet shkelje e kërkesave të ligjit procedural për njoftimin e të pandehurit. Në fillim është marrë vendimi për mosgjetjen e kërkuesit dhe më pas i është caktuar avokati kryesisht, ku këtij të fundit i janë njoftuar materialet e dosjes



dhe akuza për kërkuesin. Pas kësaj nga ana e familjarëve, me anë të një aktmarrëveshjeje, është caktuar një avokat tjetër, i cili është autorizuar për të përfaqësuar kërkuesin në të gjitha shkallët e gjykimit. Nga materialet e dosjes gjyqësore vërehet se në ankimin e bërë në Gjykatën e Apelit Vlorë, si edhe në rekursin e bërë në Gjykatën e Lartë, është ngritur vetëm pretendimi për cilësim të ndryshëm të veprës penale dhe nuk është ngritur asnjë pretendim i cili ka të bëjë me aspekte të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, siç pretendon kërkuesi në kërkesën e tij.

25. Në tërësinë e tij procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj kërkuesit në aspektin kushtetues ka qenë i rregullt, pasi interesat e tij në të tria shkallët e gjykimit janë përfaqësuar nga mbrojtësi i tij, i caktuar sipas dispozitave procedurale në fuqi.

26. Nga rrethanat e faktit, si dhe nga veprimet e kërkuesit pas kryerjes së veprës penale, Gjykata arrin në konkluzionin se autoritetet kanë respektuar procedurat në lidhje me njoftimin dhe për pasojë kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal të zhvilluar në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në gjykimin e çështjes, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë.

27. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të gjykimit në mungesë, është i papabuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, është i pa arsytuar.

29. Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimit gjyqësor si një detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës dhe një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në tërësinë e tij ai

duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngush-tësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin nr. 12, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsytimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në gjetjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Argumentet e dhëna në vendim duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsytuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimin nr. 23, datë 20.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Edhe GJEDNJ-ja, duke iu referuar procesit të drejtë, të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së, ka theksuar se kjo dispozitë i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument. Detyrimi për të arsyetuar vendimin, varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih Marini kundër Shqipërisë, 18 dhjetor 2007, § 105; Van de Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994, § 61*).

32. Sipas Gjykatës, arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e



kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 77, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se vendimet gjyqësore i kanë respektuar standardet si më sipër. Vendimet gjyqësore nuk rezultojnë të jenë alogjike, të kenë kundërthënie apo të mos kenë pasqyruar në mënyrë të mjaftueshme argumentet në mbështetje të përfundimit të shprehur në dispozitiv. Po ashtu, edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë e ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs i ka dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me to, në rastin konkret, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Në kushtet kur nuk ka pretendime të natyrës kushtetuese, vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se procesi gjyqësor nuk ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese.

34. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit si rezultat i mosnjohimit efektiv të tij nga autoritetet përgjegjëse, si dhe cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 41, datë 6.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 5.5.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 12 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Vasilika Zavalani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra

Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Korçë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), Romeo Zallemi, Edison Zavalani, Migena Zavalani, Sotir Zavalani, Dhimitër Zavalani, Ilir Gushe, Shpresa Gushe, Frederik Gushe, Zana Nure, Përmbaruesi Privat Vasil Zguro.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 2177, datë 20.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 514, datë 2.12.2011, të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 2647, datë 7.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 11155, datë 19.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të



kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, ZVRPP-së Korçë dhe ZQRPP-së, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe të përmbaruesit privat, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë Këshillit të Rrethit Korçë, me vendimin nr. 57, datë 22.5.1998 (nr. 57/1998), ka njohur pronar të sipërfaqes prej 10,861 m² trashëgimtarët e Mihal Zavalanit (M.Z.) ndër të cilët përfshihet edhe kërkuesja, duke i kompensuar sipas ligjit, në kushtet kur kjo sipërfaqe ka qenë e ndarë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 1991 “Për tokën”, i ndryshuar. Ky vendim i KKKP-së është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe është ndryshuar me vendimin nr. 277, datë 22.2.1999 (nr. 277/1999) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sipas të cilit sipërfaqja prej 10,000 m² u është kthyer në natyrë trashëgimtarëve të M.Z.

2. Me vendimin nr. 275, datë 1.9.2005, KKKP-ja pranë Këshillit të Rrethit Korçë i ka njohur të drejtën e pronësisë subjektit të interesuar Romeo Zallemi (R.Z.) mbi një truall prej 3050 m² (pika 1 e vendimit), ndërsa për pronën “tokë bujqësore”, sot truall, me sipërfaqe 950 m² nuk ia ka njohur të drejtën e pronësisë, pasi kjo sipërfaqe u është njohur e kthyer trashëgimtarëve të M.Z (pika 2 e vendimit).

3. Subjekti i interesuar R.Z. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke kërkuar, ndër të tjera, edhe ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 57/1998 të ish-KKKP-së pranë Këshillit të Rrethit Korçë dhe njohjen pronar për sipërfaqen prej 950 m² të mbivendosur me palën e paditur, trashëgimtarët e M.Z.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 2177, datë 20.7.2009 (nr. 2177/2009), ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 57/1998 të ish-KKKP-së, të ndryshuar me vendimin gjyqësor nr. 277/1999, për sa i përket kthimit të lirë të sipërfaqes prej 10,000 m². Në këtë gjykim kërkuesja ka marrë pjesë në cilësinë e përfaqësueses së të paditurit Sokrat Zavalani (S.Z.).

Faqe | 10398

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 514, datë 2.12.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2177/2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2014–2647, datë 7.10.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, si trashëgimtare ligjore e S.Z.

7. Me urdhrin nr. 957, datë 30.11.2011 (nr. 957/2011), ZQRPP-ja Tiranë ka refuzuar kërkesën e kërkueses për regjistrimin e pasurisë së përfutur me vendimin nr. 277, datë 22.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkak të pamundësisë së pozicionimit gjeografik të pasurisë dhe përcaktimit të kufijve të saj. Mbi padinë e ngritur nga kërkuesja, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ, urdhrin nr. 957/2011 të ZQRPP-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11155, datë 19.11.2012 (nr. 11155/2012), ka vendosur shfuqizimin e urdhrin administrativ dhe detyrimin e të paditurit, ZVRPP-së Korçë, të pajisë kërkuesen me certifikatë pronësie për sipërfaqen prej 10.000 m². Sipas gjykatës, vendimi nr. 277/1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me anë të cilit trashëgimtarëve të M.Z. (te të cilët përfshihet edhe kërkuesja), ka marrë formë të prerë dhe është kthyer në titull ekzekutiv.

8. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur mosshqyrtimin e çështjes dhe dërgimin për kompetencë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 2421, datë 17.6.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 11155/2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për këtë vendim është nxjerrë edhe urdhri i ekzekutimit nr. 5583, datë 17.10.2014.

II

9. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se është cenuar:

9.1 Parimi i sigurisë juridike në lidhje me gjënë e gjykuar, pasi gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale (KPC), ka prishur vendime gjyqësore të formës së prerë, ka bërë gjykim për herë të dytë mbi pronën, si dhe nuk ka marrë parasysh vendimet e KKKP-ve, urdhrat e ekzekutimit që kanë dalë për zbatim të vendimeve gjyqësore të



formës së prerë dhe vërtetimet e pronësisë të lëshuara nga ZRPP-ja Korçë. Padia e subjektit të interesuar është ngritur pas 10 vjetësh nga zotërimi i ligjshëm i pronës.

9.2 E drejta e pronës, pasi janë lënë pa fuqi juridike tri vendime gjyqësore të formës së prerë, në të cilat gjykatat janë shprehur përfundimisht për të drejtat e pronës së kërkueses.

9.3 E drejta e aksesit nga ana e Gjykatës së Lartë, e cila nuk ka pranuar rekursin e paraqitur dhe nuk ka dhënë përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e ngritura në të.

9.4 Parimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, pasi edhe pse ka dalë urdhri i ekzekutimit për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ende nuk është ekzekutuar nga ZVRPP-ja Korçë. Kjo e fundit nuk e ka pajisur kërkuesen me certifikatë pronësie.

10. **Subjekti i interesuar**, ZVRPP-ja Korçë, ka prapësuar si vijon:

10.1 Skica që shoqëron vendimin nr. 57/1998 të KKKP-së është e njëjtë me atë që shoqëron vendimin nr. 277/1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe i mungojnë elementet themelore orientuese të një harte treguese apo plani rivelim. Për pronën e kërkueses nuk është hapur kartelë dhe nuk është bërë pasqyrimi i saj në hartë, ndaj kalimi i regjistrimit fillestar të pronës në regjistrin e ri të hipotekës, ku prona duhet të pasqyrohet gjeografikisht në hartën treguese, nuk mund të bëhet. Pamundësia e pozicionimit gjeografik të pasurisë dhe përcaktimit të kufijve të saj kanë qenë shkaqet e nxjerrjes së urdhrin të refuzimit nga ana e Kryeregjistruesit. Ndonëse vendimi nr. 277/1999 është titull pronësie, sipas Kodit Civil (KC), mungesa e të dhënave të plota teknike në të e bëjnë të pamundur regjistrimin e pronës në regjistrin e ri të hipotekës.

10.2 Vendimet gjyqësore që kanë shfuqizuar urdhrin e Kryeregjistruesit dhe kanë vendosur detyrimin e ZVRPP-së Korçë të pajisë kërkuesen me certifikatë pronësie nuk i kanë dhënë zgjidhje problemit në lidhje me pozicionimin gjeografik të sipërfaqes prej 10.000 m², që përbën dhe shkakun e refuzimit të regjistrimit të vendimit gjyqësor nr. 277/1999 në sistemin e ri të hipotekës.

10.3 Kërkesa e kërkueses për regjistrim është marrë në shqyrtim nga ZVRPP-ja Korçë, e cila, për shkak të problematikës së çështjes konkrete, ka kërkuar edhe orientim nga organi epror, ZQRPP-ja, por deri më sot nuk ka pasur një të tillë. Kjo zyrë ka marrë të gjitha masat administrative, të cilat hyjnë në kompetencat e saj, për të zgjidhur problemin e kërkueses. Ajo ka ngritur një grup pune me specialistë, ka diskutuar çështjen me specialistët e saj në prani të kërkueses, ka kryer verifikimet në terren, ka realizuar takime me kërkuesen dhe përmbauesin gjyqësor, si dhe ka vënë në dijeni institucionet përkatëse (ZQRPP-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe Avokatin e Popullit) për kompleksitetin e çështjes konkrete.

10.4 Kërkuesja refuzon t'i vërë në dispozicion ZVRPP-së një plan të ri rivelim dhe po kështu edhe përmbauesi refuzon t'i vërë në dispozicion piktimin që ka bërë në terren, veprime të cilat bien ndesh me dispozitat përkatëse ligjore.

11. **Subjekti i interesuar**, ZQRPP-ja, ka parashtruar qëndrimin e saj në lidhje me rastin e kërkueses. ZQRPP-ja ka nxjerrë urdhrin nr. 957/2011 me të cilin ka miratuar projekturdrhin e refuzimit të regjistrimit të pronës së kërkueses. Arsyeja e refuzimit ka qenë pamundësia e evidentimit të pasurisë dhe hedhjes së saj në sistemin HTR. Ajo i ka kërkuar kërkueses të përgatisë një plan rivelim nga një topograf i licencuar, kërkesë e cila është refuzuar nga kërkuesja. Pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shfuqizuar këtë urdhër administrativ dhe ka vendosur detyrimin e ZVRPP-së të pajisë me certifikatë pronësie kërkuesen, ZQRPP-ja e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të ankimuar. Në kushtet kur asnjë nga shkaqet e refuzimit të ngritura në urdhrin e refuzimit nr. 957/2011 nuk ka gjetur zgjidhje në vendimet gjyqësore, ZVRPP-ja e ka pasur të pamundur pozicionimin e pasurisë në fjalë. ZQRPP-ja, me shkresën nr. 181/10, datë 22.6.2015, në lidhje me trajtimin e pronës së kërkueses, ka orientuar ZVRPP-në Korçë të verifikojë planvendosjen e pronës së dhënë nga KVKKP-ja, Qarku Korçë, nëse përputhet me parcelën 71, ku kërkuesja pretendon se ndodhet prona e saj, të pozicionojë parcelat 71 dhe 68 në hartën kadastrale, të regjistrojë sipërfaqen e



truallit prej 10.000 m², që i është kthyer kërkueses, si dhe të pajisë këtë të fundit me certifikatë pronësie.

12. **Subjekti i interesuar**, përmbaruesi privat Vasil Zguro, ka parashtruar se ai i ka kryer të gjitha veprimet përmbarimore në përputhje me kuadrin ligjor përkatës. Kështu, debitorit i është dërguar fillimisht lajmërimi për ekzekutim vullnetar, bashkë me dokumentacionin e pronës dhe praktikën përmbarimore. Në kushtet kur debitori nuk ka pajisur me certifikatë pronësie kërkuesen, është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

13. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e saj, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashkuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka ngritur pretendime të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Gjykata ka theksuar se bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj, dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që iu është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (shih vendimin nr. 47, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Duke iu referuar pretendimeve të paraqitura nga kërkuesja, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjnë me cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të parimit të disponibilitetit në gjykim. Në vijim janë shqyrtuar këto pretendime në kontekstin e gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e disponibilitetit në gjykim

15. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me kërkesat e KPC-së, ka prishur vendime gjyqësore të formës së prerë, ka

bërë gjykim për herë të dytë mbi pronën, si dhe nuk ka marrë parasysh urdhrat e ekzekutimit që kanë dalë në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Sipas saj, padia e subjektit të interesuar R.Z. është ngritur pas 10 vjetësh nga zotërimi i ligjshëm i pronës. Kërkuesja ka pretenduar gjithashtu se megjithëse ajo i ka parashtruar në rekurs këto shkaqe, Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin e paraqitur dhe nuk ka dhënë përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e ngritura në të.

16. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Edhe në lidhje me parimin *res judicata*, Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndër mënyrat të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shtetit, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (shih vendimet nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Gjithashtu, Gjykata është shprehur se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Lidhur me vendimet gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që,



në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor e janë analizuar bashkërisht edhe në funksion të standardeve të tjera kushtetuese që karakterizojnë këtë të drejtë (*shih vendimet nr. 16, datë 19.4.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 6, datë 15.4.2005; nr. 20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 2 të KPC-së. Iniciativa për të filluar procesin i takon paditësit, sepse gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari - “Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe” (neni 2 i KPC-së). Në çdo rast është pala që përcakton objektin e gjykimit, kështu që gjykata nuk mund të dalë jashtë objektit të padisë. Pra, në përputhje me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile “gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet” (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. E drejta për të disponuar mbi objektin e padisë është një e drejtë e paditësit, i cili e ushtron duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet në objektin e padisë sipas interesave të tij. Gjykata nuk mund të diktojë objektin e padisë dhe as të pengojë paditësin në ushtrimin e së drejtës për të disponuar mbi këtë objekt (*shih vendimin nr. 6, datë 15.4.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nga rrethanat faktike të çështjes në shqyrtim konstatohet se kërkueses dhe trashëgimtarëve të tjerë të M.Z., nëpërmjet vendimit nr. 57/1998 të KVKKP-së Korçë, u

është njohur e drejta e pronësisë dhe e kompensimit për sipërfaqen prej 10,861m². Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila, me vendimin nr. 277/1999 të formës së prerë, ka përcaktuar kthimin në natyrë të sipërfaqes prej 10,000 m² nga sipërfaqja e përgjithshme. Vendimi nr. 57/1998 i KVKKP-së është bërë sërish objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Shkaku i padisë ka qenë pretendimi i subjektit të interesuar R.Z. për mbivendosjen e sipërfaqes prej 950 m² në pronën prej 10,000 m² të trashëgimtarëve të M.Z. Me vendimin nr. 2177/2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 57/1998 i KVKKP-së, për sa i përket kthimit të lirë të sipërfaqes prej 10,000 m². Në vendimin e saj gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se “prona e ish-pronarit Mihal Zavalani nuk ndodhet atje ku i është kthyer me vendimin gjyqësor nr. 277, datë 22.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Komisioni ka gabuar, pasi megjithëse ka konstatuar se prona e pretenduar nga trashëgimtarët e M.Z. nuk ndodhet atje ku kërkohet prej tyre, ia ka njohur pronësinë, ndërkohë që nuk duhet t’ia njihje atë. Më tej, gjykata, me vendimin nr. 277, datë 22.2.1999, ka ndryshuar vendimin e komisionit, duke e kthyer të lirë sipërfaqen prej 10,000 m², pa vlerësuar dhe çmuar konkluzionin e komisionit se dokumentacioni teknik, pra planvendosja e depozituar nuk përfaqëson realitetin lidhur me vendndodhjen e pronës. Duke ndryshuar vendimi i komisionit mbetet pa fuqi vendimi gjyqësor që e ka ndryshuar atë [...] (në këtë rast vendimi gjyqësor ka karakteristikat e një vendimi të një organi administrativ që ka ndryshuar një vendim të një organi më të ulët administrativ dhe me rënien nga fuqia të vendimit të ulët administrativisht, bëhet inekzistent dhe vendimi i hallkës administrative më të lartë)” (*shih f. 6–7, 9–10 të vendimit nr. 2177/2009*). Bazuar në këtë arsyetim, gjykata në dispozitiv është shprehur për “ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 57/1998 të ish-KVKKP-së pranë Këshillit të Rrethit Korçë, të ndryshuar me vendimin nr. 277/1999 të Gjykatës së Rrethit Korçë, për sa i përket kthimit të lirë të sipërfaqes prej 10,000 m², si më poshtë: të njohë pronat e ish-pronarit Mihal Zavalani, duke i kompensuar në një nga mënyrat që cakton ligji për sipërfaqen prej 10.031 m²”.

22. Në ankimin e paraqitur përpara Gjykatës së Apelit kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të gjësë së gjykuar. Sipas saj, çështjet e



pozicionimit të pronës dhe kthimit të saj në natyrë janë zgjidhur me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 277/1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesja, Gjykata e Apelit është shprehur se “janë të pabazuara në ligj dhe prova e nuk ka vend të merren parasysh” (*shih f. 6 të vendimit nr. 514/2011*).

23. Gjykata vëren se edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkuesja ka evidentuar se “pronësia është fituar përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili ka saktësuar vendndodhjen e pronës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë pas 10 vjetësh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë e ka shfuqizuar atë, duke shkelur haptazi ligjin dhe çdo parim të së drejtës”. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2647, datë 7.10.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit. Në jurisprudencën e saj konstante Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 58, datë 24.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Kërkuesja në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket respektimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, vendim i cili ka konkretizuar të drejtën e pronës dhe është shprehur mbi kthimin e saj në natyrë. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese. Gjykata për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë

në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej mbi to, në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit.

24. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka lejuar zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor, pasi në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t'u jepte përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuesja.³

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm

25. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar parimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, pasi edhe pse ka dalë urdhri i ekzekutimit nr. 5583, datë 17.10.2014 për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 11155/2012, ky urdhër ende nuk është ekzekutuar nga ZVRPP-ja Korçë. Kjo e fundit nuk e ka pajisur kërkuesen me certifikatë pronësie.

26. Gjykata është shprehur edhe më parë në jurisprudencën e saj se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se, në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte

³ Gjyqtari Sokol Berberi votoi për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, por bazuar mbi argumente të tjera.



civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga rrethanat e çështjes rezulton se në bazë të vendimit të formës së prerë nr. 277/1999 pasuria prej 10,000 m² e kthyer në natyrë është regjistruar në radhorët e ZVRPP-së Korçë me nr. 114/17, datë 24.6.1999 (*shih shkresën nr. 4635 prot., datë 9.9.2011 të ZQRPP-së*). Në datën 18.4.2011 kërkuarja ka aplikuar për të marrë certifikatën e pronësisë. ZVRPP-ja Korçë e ka bërë me dije kërkuarjen se nuk mund ta pajisë me certifikatë pronësie, pasi dosja e praktikës ka mangësi në dokumentacion dhe i ka kërkuar asaj ta plotësojë. ZVRPP-ja Korçë është shprehur se skicës bashkëlidhur vendimit nr. 277/1999 i mungojnë elementet orientuese për të përcaktuar pozicionimin gjeografik të pronës, në mënyrë që ajo të hidhet në hartë në sistem. Në këto kushte, ZVRPP-ja Korçë ia ka kaluar praktikën ZQRPP-së, e cila, me urdhrin nr. 957/2011, ka refuzuar kërkesën e kërkuarjes për regjistrimin e pasurisë në sistemin e ri të regjistrimit. Shkak për këtë është bërë “mungesa e elementeve orientuese në hartë dhe për pasojë pamundësia për evidentimin gjeografik të pronës dhe hedhja e saj në HTR” (*shih urdhrin nr. 957/2011 të Kryeregjistruesit*). Ky urdher është bërë objekt kundërshtimi në gjykatë dhe në përfundim të gjykimit është shfuqizuar. Bashkë me shfuqizimin gjykata ka vendosur detyrimin për ZVRPP-në Korçë të pajisë me certifikatë pronësie kërkuarjen. Megjithatë, problemi kryesor, që është pamundësia e pozicionimit gjeografik të pronës, nuk është zgjidhur nga gjykata. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se çështja është komplekse.

29. Në lidhje me sjelljen e kërkuarjes Gjykata konstaton se asaj i është kërkuar nga ZVRPP-ja Korçë të plotësojë dokumentacionin dhe të

paraqesë një plan të ri nivelimi, të cilin ajo nuk e ka paraqitur. Dokumentet që ajo ka dorëzuar kanë qenë të pamjaftueshme për përcaktimin e pozicionit gjeografik të pronës (*shih urdhrin nr. 957/2011 të Kryeregjistruesit dhe shkresën nr. 2941/1 prot, datë 4.6.2015 të ZVRPP-së Korçë*). Kërkuarja u është drejtuar, gjithashtu, institucioneve shtetërore (Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit, përmbaresit privat etj.) për t'u ankuar ndaj drejtueses së ZVRPP-së Korçë për mospajisjen e saj me certifikatë pronësie.

30. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve shtetërore, ZVRPP-së Korçë dhe ZQRPP-së, rezulton se ato kanë bërë përpjekje për të zgjidhur problemin, me qëllim regjistrimin e pasurisë në hartë dhe pajisjen e kërkuarjes me certifikatë pronësie. Kështu, ZVRPP-ja Korçë i është drejtuar ZQRPP-së për orientim për zgjidhjen e problemit. Edhe grupi i punës i ngritur nga kjo zyrë ka shkuar në terren për të bërë verifikime, por e ka pasur të pamundur të bëjë pozicionimin e pronës. Kryeregjistruesi së bashku me një grup specialistësh kanë diskutuar problematikën në prani të kërkuarjes. Po kështu, regjistruesit vendorë e kanë pritur në takim disa herë kërkuarjen, duke shprehur vullnetin për të zgjidhur problemin. Me shkresën nr. 181/10 prot., datë 22.6.2015 ZQRPP-ja e ka orientuar ZVRPP-në Korçë të verifikojë planvendosjen e pronës dhe më pas të bëjë regjistrimin dhe pajisjen e kërkuarjes me certifikatë pronësie.

31. Për sa më sipër, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, faktin se ajo është ende në proces për t'u zgjidhur, si dhe vullnetin e shprehur nga ana e autoriteteve për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarjes për moszekutimin brenda një afati të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë është i pambështetur.

32. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen konkrete, Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duke mos ushtruar funksionin e saj kontrollues për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g



të Kushtetutës, si dhe të nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës⁴. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00–2014–2647, datë 7.10.2014 të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuese Vasilika Zavalanin bashkohem me qëndrimin e shumicës për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, por jo me argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim. Vlerësoj se është vendimi i Gjykatës së Apelit që ka lejuar cenimin e sigurisë juridike, për rrjedhojë duhet të ishte shfuqizuar edhe ky vendim. Shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë vjen si pasojë e moskorigjimit të cenimit të procesit të rregullt të lejuar në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit. Gjithashtu, mendoj se duhej të pranohej edhe pretendimi për cenimin e afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Arsyet mbi të cilat mbështet ky qëndrim janë si më poshtë.

2. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me gjënë e gjykuar, pasi gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me kërkesat e KPC-së, ka prishur vendime gjyqësore të formës së prerë, ka bërë gjykim për herë të dytë mbi pronën, si dhe nuk ka marrë parasysh vendimet e KKKP-ve, urdhrat e

ekzekutimit që kanë dalë për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe vërtetimet e pronësisë të lëshuara nga ZRPP-ja, Korçë. Sipas saj, padia e subjektit të interesuar është ngritur pas 10 vjetësh nga zotërimi i ligjshëm i pronës. Ajo ka pretenduar gjithashtu cenimin e parimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se edhe pse ka dalë urdhri i ekzekutimit për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ky vendim ende nuk është ekzekutuar nga ZVRPP-ja Korçë. Kjo e fundit nuk e ka pajisur kërkuësen me certifikatë pronësie.

3. Lidhur me pretendimin e kërkuëses për cenimin e parimit të sigurisë juridike në lidhje me gjënë gjykuar, shumica ka vlerësuar se Gjykata e Lartë ka lejuar zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor, pasi në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet t’u jepte përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuësja. Për rrjedhojë, ajo ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00–2014–2647, datë 7.10.2014 të Gjykatës së Lartë. Siç u shpreha edhe më sipër, cenimi i procesit të rregullt është lejuar nga Gjykata e Apelit, cenim ky që nuk është korigjuar më pas gjatë kontrollit në Gjykatën e Lartë.

4. Kështu kërkuësja në ankimin e paraqitur në Gjykatën e Apelit ka ngritur pretendime për sa i përket cenimit të sigurisë juridike në lidhje me pronën prej 10,000 m², mbi të cilën është disponuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka bërë gjykim për herë të dytë mbi pronën, si dhe nuk ka marrë parasysh vendimet e KKKP-ve dhe urdhrat e ekzekutimit që kanë dalë për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Megjithatë edhe pse kërkuësja i ka evidentuar këto të meta dhe e ka ngritur pretendimin e cenimit të sigurisë juridike në lidhje me gjënë e gjykuar në ankimin e paraqitur në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit nuk i ka korigjuar ato dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuëses.

5. Të njëjtin pretendim për cenimin e sigurisë juridike në lidhje me gjënë e gjykuar, kërkuësja e ka ngritur edhe në Gjykatën e Lartë, në rekursin e paraqitur kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata e Lartë nuk i ka korigjuar të

⁴ Gjyqtari Sokol Berberi votoi edhe për shfuqizimin e vendimit nr. 514, datë 2.12.2011, të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.



metat e vërejtura në vendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Vlerësoj se në rastin konkret shkella e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Apelit Korçë nuk është plotësuar ose korrigjuar nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte arrihet në përfundimin se edhe Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues dhe, për këtë arsye vendimi duhet të shfuqizohet.

6. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuësës, për cenimin e afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, vlerësoj se është i bazuar dhe duhej pranuar. Në lidhje me këtë pretendim shumica ka vlerësuar se duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, faktin që ajo është ende në proces për t'u zgjidhur, si dhe vullnetin e shprehur nga ana e autoriteteve për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë, pretendimi i kërkuësës për mosekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë është i pambështetur. Nuk pajtohem me këtë arsyetim të shumicës.

7. Nga rrethanat e çështjes rezulton se në bazë të vendimit të formës së prerë nr. 277/1999 pasuria prej 10,000 m² e kthyer në natyrë është regjistruar në radhorët e ZVRPP-së Korçë me nr. 114/17, datë 24.6.1999 (*shih shkresën nr. 4635 prot., datë 9.9.2011 të ZQRPP-së*). Në datën 18.4.2011 kërkuësja ka aplikuar për të marrë certifikatën e pronësisë. ZVRPP-ja Korçë e ka bërë me dije kërkuësen se nuk mund ta pajisë me certifikatë pronësie, pasi dosja e praktikës ka mangësi në dokumentacion dhe i ka kërkuar asaj ta plotësojë. ZVRPP-ja Korçë është shprehur se skicës bashkëlidhur vendimit nr. 277/1999 i mungojnë elementet orientuese për të përcaktuar pozicionimin gjeografik të pronës në mënyrë që ajo të hidhet në hartë në sistem. Në këto kushte ZVRPP-ja Korçë ia ka kaluar praktikën ZQRPP-së, e cila, me urdhrin nr. 957/2011, ka refuzuar kërkesën e kërkuësës për regjistrimin e pasurisë

në sistemin e ri të regjistrimit. Ky urdhër është bërë objekt kundërshtimi në gjykatë dhe në përfundim të gjykimit është shfuqizuar. Bashkë me shfuqizimin gjykata ka vendosur detyrimin për ZVRPP-në Korçë që të pajisë me certifikatë pronësie kërkuësen. Por edhe pas kësaj kërkuësja nuk është pajisur me certifikatë pronësie. Ajo u është drejtuar institucioneve shtetërore (Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit, përmbauesit privat etj.) për t'u ankuar ndaj drejtueses së ZVRPP-së Korçë për mospajisjen e saj me certifikatë pronësie.

8. Autoritetet shtetërore, ZVRPP-ja Korçë dhe ZQRPP-ja, kanë bërë përpjekje për të zgjidhur problemin, me qëllim regjistrimin e pasurisë në hartë dhe pajisjen e kërkuësës me certifikatë pronësie. Kështu ZVRPP-ja Korçë i është drejtuar ZQRPP-së për orientim për zgjidhjen e problemit. Edhe grupi i punës i ngritur nga kjo zyrë ka shkuar në terren për të bërë verifikime, por e ka pasur të pamundur të bëjë pozicionimin e pronës. Kryeregjistruesi së bashku me një grup specialistësh kanë diskutuar problematikën në prani të kërkuësës. Regjistru-uesit vendorë kanë pritur në takim disa herë kërkuësen duke shprehur vullnetin për të zgjidhur problemin. Me shkresën nr. 181/10 prot., datë 22.6.2015, ZQRPP-ja është shprehur që nga ana e ZVRPP-së Korçë të verifikohet planvendosja e pronës dhe më pas të bëhet regjistrimi dhe pajisja me certifikatë.

9. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve shtetërore për të zgjidhur problemin dhe kompleksitetit të çështjes, e drejta e kërkuësës për t'u pajisur me certifikatë pronësie, që i është njohur me vendimin nr. 11155/2012 të formës së prerë, ende nuk është realizuar. Në vlerësimin tim të gjitha këto nuk e justifikojnë një kohëzgjatje kaq të madhe për të realizuar të drejtat e kërkuësës. Për rrjedhojë, çmoj se në rastin konkret është cenuar parimi i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

10. Si përfundim çmoj se shumica duhej ta pranonte pretendimin e kërkuësës për cenimin e afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Gjithashtu, ajo përveç shfuqizimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, duhej të shfuqizonte edhe vendimin e Gjykatës së Apelit.

Anëtar: Sokol Berberi



VENDIM

Nr. 63, datë 6.7.2016

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “FONDI PËR GRATË SIPËRMARRËSE NË BASHKINË E TIRANËS”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- z. Milva Ekonomi kryetar;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtar;
- z. Ahmet Maçellari anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 7.4.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, morri në shqyrtim “Planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Fondi për gratë sipërmarrëse në Bashkinë e Tiranës””.

I. Procedura

1. Njoftimi i skemës është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Bashkia Tiranë, me shkresën nr. prot. 177/1, datë 9.6.2016.

II. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

2. Konteksti: Fuqizimi ekonomik i grave, si nëpërmjet rritjes së aksesit në tregjet e punës edhe nëpërmjet përmirësimit të mundësive për sipërmarrjen e grave është një fushë që gradualisht po fiton vëmendje dhe mbështetje nga qeveria shqiptare si një mjet për të garantuar konsolidimin e të drejtave të grave. Forcimi i sipërmarrjes së grave është theksuar në disa dokumente dhe strategji të zhvilluara nga qeveria, siç janë Strategjia e Biznesit dhe Zhvillimit 2013–2020 dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020. Për ta vazhduar më tej këtë shtysë dhe për të bërë të mundur suksesin e financimit të veçantë për gratë, Bashkia e Tiranës ka hartuar projektin e Fondit të Grave Sipërmarrëse me fokus gratë sipërmarrëse që ushtrojnë aktivitetet tregtar në Tiranë.

3. “Fondi i Grave Sipërmarrëse” është një projekt i Bashkisë së Tiranës, i financuar nga burime publike (të parashikuara në zërin e buxhetit të Bashkisë Tiranë “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes”) dhe i projektuar për të

mbështetur krijimin ose zgjerimin e aktiviteteve të zbatueshme të biznesit nga gratë, të afta për të pasur sukses në një treg konkurrues. Fondi synon të mbështesë drejtpërdrejt industri të ndryshme të ndërmarrjeve shumë të vogla dhe të mesme në pronësi të grave, si edhe do të nxisë gratë për të filluar aktivitetet e tyre në biznes. Projektit do të bazohet në një proces aplikimi dhe përzgjedhje të drejtë dhe konkurrues, trajnim në aftësi bazë të biznesit, përgatitje të një plani biznesi të shëndoshë dhe të zbatueshëm, mbështetje financiare (nëpërmjet ofrimit të granteve) për të filluar biznesin, dhe udhëheqje. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve synon të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të ndershme dhe të mbështesë idetë më të mira, unike dhe të besueshme dhe planet e biznesit që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

4. Objektivi: Plani i ndihmës ka si objektiv të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga gratë në Tiranë, të cilat janë të afta të mbijetojnë në një treg konkurrues. Fondi synon të mbështesë drejtpërdrejt industri të ndryshme të ndërmarrjeve shumë të vogla dhe të mesme në pronësi të grave, si edhe do të nxisë gratë për të filluar aktivitetet e tyre në biznes. Dhënia e granteve për gratë, veçanërisht grantet e biznesit për gratë, synon të ndihmojë në rritjen krijimin e kushteve të barabarta përmes ofrimit të ndihmës financiare që u mundëson atyre të konkurrojnë në tregun e sotëm.

5. Baza ligjore: Baza ligjore për dhënien e ndihmës është:

a) Neni 24 i ligjit nr. 139/2015, “Për vetë-qeverisjen vendore”;

“Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.



4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”

b) Buxheti vjetor i Bashkisë Tiranë 2016, i miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 58, datë 30.1.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016–2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016”. Programi 10150 “Kujdesi social”.

6. Buxheti dhe mënyra e financimit: Fondi total i ndihmës në vitin 2016 është 6 milionë lekë. Plani i ndihmës ofron asistencë në formë granti nga 280.000 në 420.000 lekë për secilin plan biznesi të zhvilluar me sukses, i cili është pranuar gjatë procesit të përzgjedhjes, së bashku me asistencën për udhëheqje deri në dy vite pas fillimit të zbatimit të planit të biznesit.

7. Intensiteti i ndihmës: Fondi i Grave Sipërmarrëse u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla deri në 80% të kostove të pranueshme, por në asnjë rast jo më shumë se 280.000–420.000 lekë. Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot, për:

a) qiranë për mjediset për zyra dhe shërbimet e biznesit;

b) blerjen e materialeve për mobilim ose rregullim të mjediseve/godinave për biznesin;

c) blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme;

d) blerjen para fillimit të materialeve të përpunuara dhe produkteve të konsumueshme;

e) rrogat dhe pagat, dhe shërbime të tjera të specializuara të nevojshme (kontabilitet, administrim, IT etj.);

f) promovimin dhe reklamimin e aktiviteteve.

Brenda kufirit të financimit të kostove të pranueshme do të aplikohen edhe disa kufizime, si më poshtë:

- deri në 30% të grantit mund të përdoret për mobilim të mjediseve (deri në 50% lejohet vetëm për shërbime hotelerie);

- blerja e materialeve të papërpunuara mund të mbulohet vetëm një herë, si blerje e vetme e stokut fillestar;

- rrogat dhe pagat mund të mbulohen deri për gjashtë muaj pas fillimit të biznesit, bazuar në rrogën mesatare në Shqipëri (pjesa tjetër e rrogës duhet të mbulohet nga vetë biznesi);

- reklamimi mund të mbulohet vetëm për gjashtë muajt e parë pas fillimit dhe nuk mund të tejkalohet më shumë se 10% të grantit total.

8. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2016 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare, deri në vitin 2018.

9. Përfituesit: Përfitojnë nga plani i ndihmës ndërmarrje të vogla ose shumë të vogla në territorin e Bashkisë së Tiranës, në momentin e aplikimit dhe që janë në pronësi të grave. Janë të avantazuara për përfitim të ndihmës ato ndërmarrje të vogla dhe mikro, që zotërohen nga grupet e mëposhtme:

- gratë e reja (18–35 vjeç);

- gratë nga zonat rurale të Bashkisë së Tiranës;

- gratë kryefamiljare;

- gratë me aftësi të kufizuara;

- dhe gratë nga grupet e minoriteteve etnike.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

10. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurispru-dencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikimeve dhe detyrimit që buron nga nenin 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

“2. Praktikant në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

11. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, këto kushte:

a) aktivizohen burime shtetërore;

b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe

c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën

d) ka ndikim në tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet



shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”.

Burimet shtetërore

12. Zbatimi i projektit aktivizon burime shtetërore, sepse financohet direkt nga buxheti i i Bashkisë Tiranë.

Bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 9374/2005:

1. “Dhënës së ndihmës shtetërore” janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.

8. “Burime shtetërore” janë burimet e buxhetit të shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njëjësive të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

13. Skema e ndihmës ka karakter selektiv sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro dhe të vogla, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në projekt vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, dhe të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare në hapësirën territoriale administrative të Bashkisë Tiranë. Rrjedhimisht, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg kanë aftësinë për të aplikuar dhe përfutur nga mbështetja financiare. Ndërmarrjet përfutuese kanë avantazh ekonomik, kundrejt ndërmarrjeve të tjera, pasi ato marrin nga bashkia një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk mund ta siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

14. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Konkluzion

Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfutuese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka

efekt në konkurrencë dhe tregti, drejtoria vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore vlerëson se:

Neni 8 i ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon se:

“Ndihma është e lejueshme nëse ajo, pavarësisht formës ose qëllimit për të cilin jepet, nuk kalon vlerën prej 100.000 eurosh, për një periudhë financiare prej tre vjetësh dhe, në të njëjtën kohë, nuk jepet për veprimtaritë e eksportit, nuk kushtëzohet me përdorimin e produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara dhe përfutuesi nuk është një ndërmarrje në vështirësi.”.

Ndihma lejohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrje nuk i kalon 100.000 euro, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa konsiston në dhënie e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në asnjë rast kjo ndihmë nuk mund të kalojë shumën e 280,000 në 420,000 lekë për ndërmarrje.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) ndihma është transparente, granti dhe subside në të holla janë ndihmë transparente⁵. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, duke qenë në kushtet e përmbushjes së të gjitha kriterëve të përcaktuara nga neni 8, Drejtoria e Tregut të Brendshëm vlerëson se skema “Fondit për Gratë Sipërmarrëse” është një skemë ndihme që lejohet.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, nenit 8, nenit 17, neni 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

⁵ Neni 4, COMMISSION REGULATION (EU) No. 1407/2013



VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për Fondin e Grave Sipërmarrëse”, si një skemë ndihme të lejueshme.

2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës finan-ciar.

4. Bashkia e Tiranës të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

KËRKESË

Nr. 3740, datë 4.7.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Pedonalja Abaz Bej Lushnja”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 12,165,523 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

Tabela e Pasurive që shpronësohen, që preken nga zbatimi i Projektit “Rikonstruksion i rruges pedonale Abaz Bej Lushnja”

Nr	Pronari		Zona Kadastrale	Nr. pasurise	Lloji i ndertimit	Siperfaqja		Cmimi		Vlera		Vlera gjithsej truall+ndretese se	Konfirmimi i ZVRPP-se
	Emer	Mbiemer				Truall	Ndertese	Truall	Ndertese	Truall	Ndertese		
1	Nuri	Beqiri	8571	18/136+1-1,-2,-3	Banese	0	292	9709	40100	0	11709200	11709200	Konfirmuar Nr.4941/1prot,dt 15.06.2016
2	Nuri	Beqiri+ bashk.	8571	18/180	Truall	47	0	9709	0	456323	0	456323	Konfirmuar Nr.4941/1prot,dt 15.06.2016
Shuma total												12165523	

Shenim : Siperfaqja e truallit e z.Nuri Beqiri+Bashkepronare eshte 115m2 dhe kesaj siperfaqje eshte zbritur gjurma e nderteses se katit per dhe te baneses prej 68m2 te z.Nuri Beqiri .

KËRKESË

Shtetasi Taulant Malko kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen të vdekur të shtetasit Pëllumb Malko, i biri i Qamilit dhe i Files, i datëlindjes 25.4.1963, lindur në Zharrnec, Bashkia Divjakë.

KËRKUES
Taulant Malko

KËRKESË

Shtetasi Flamur Beqiraj kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpalljen të zhdukur të djalit të tij, shtetasit Pellump (Pellumb) Beqiraj, i biri i Flamurit dhe i Hajries, i datëlindjes 26.5.1972, lindur në Kuçovë.

KËRKUES
Flamur Beqiraj



KËRKESË

Shtetasja Gentiana Ahmetli kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, shpalljen e vdekjes së bashkëshortit të saj, shtetasit Elvis Ahmetli, i biri i Tekiut dhe i Pranverës, i datëlindjes 21.3.1974.

KËRKUES
Gentiana Ahmetli

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë